

## **Metodat per kryerjen e pagesave**

### **Cilat jane metodat e pageses se energjise elektrike?**

Furnizuesi informon Klientin mbi mundësitë që ka ofruar për mënyrën e pagesës së faturës mujore të energjisë elektrike duke garantuar mundësinë për kryerjen e pagesave:

- në Zyrat e Furnizuesit,
- bankave, zyra postare,
- apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare

Sipas Marrëveshjes me Klientin faturat mund të dërgohen:

- Klientit në adresën e përcaktuar në kontratë;
- Në adresë të një personi të tretë, i cili është përcaktuar si pagues nga Klienti sipas pëlqimit të tij.

Në rast se Klienti ndërron vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mos pagesat e faturave të energjisë.